

AKTI I THEMELIMIT

i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
Albanian Satellite Communications sh.p.k



Kjo marreveshje lidhet sot me date 28 / 06, 2006 midis:

Z. Artan Dulaku, biri i Nikos dhe Lirikes, lindur me 30/05/1965 ne Tirane, Shqiperi, banues ne Rr. "Pjeter Bogdani" nr. 24/4, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. Z 0031648

Z. Benjamin Feinberg, i biri i Alfredit dhe Myras, lindur me 06/03/69, ne Pretoria, Afrika e Jugut dhe rezident ne Bar-Ilan Street nr 13, Raanana, Israel, mbajtes i pasaportes Izraelite nr. 10914164, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Z. Arian Kraja, i biri i Skenderit dhe Drites, lindur me 10/08/1965 ne Tirane, Shqiperi, banues ne Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 7/1 Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. Z 0232605

(ketu poshte Dulaku, Feinberg dhe Kraja, si edhe cdo person qe do t'i bashkohet ne te ardhmen kesaj marreveshje, do te quhen se basahku si "Palet" ose vecmas si "Pala").

PERSA ME SIPER, Palet bien dakort si me poshte:

Neni 1 **Emri i Shoqerise**

Emri i Shoqerise eshte "Albanian Satellite Communications sh.p.k", shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.

Neni 2 **Selia**

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Rr. Don Bosko, Kulla 4, Kati 2, Tirane, Shqiperi.

Neni 3 **Kohezgjatja**

Aktiviteti i Shoqerise fillon ditën e regjistrimit te saj ne Gjykate dhe vazhdon deri me Dhjetor 2100.



Neni 4 Objekti

- Aktiviteti i shërbimit në fushën e telekomunikacionit, transmetimit satelitor, transmetimit të të dhënave, figure, video, kërkime, konsultime, projekte, organizim, shpërndarja e produkteve të teknologjisë së lartë, shitja dhe zbatimi i studimeve të ndryshme, të miratuara në bazë të lejeve nga institucionet përkatëse;
- Investime në infrastrukturën e transmetimit të të dhënave, investime direkte ose përdorimi i kapaciteteve të tregut, etj;
- Investimi i kapitalit dhe rrugë të tjera financimi për blerjen e pasurive të patundshme dhe në vazhdim të aktiviteteve të për arritjen e objektivave të shoqërisë;
- Zhvillimi i projekteve për rindertimin e ndërmarrjes industriale, pas dhe në bazë të lejeve të miratuara për shoqërinë nga institucionet e fushave përkatëse.

Neni 5 Ortakët

Kapitali themelor i derdhur i Shoqërisë "është 100.000 (njëqindmijë) leke, i ndarë në 100 (njëqind) kuota me vlerë nominale prej 1.000 (njemijë) leke për kuota. Të gjitha palet kanë nënshkruar dhe derdhur pjesën e tyre të kapitalit.

Palet zoterojnë kuota e mëposhtme të kapitalit të Shoqërisë:

- a) Dulaku zoteron 65 (gjashtëdhjetepese) pjesë të kapitalit, të barabartë me 65% (gjashtëdhjetepese përqind) të kapitalit;
- b) Feinberg zoteron 25 (njetepese) pjesë të kapitalit, të barabartë me 25% (njetepese përqind) të kapitalit;
- c) Kraja zoteron 10 (dhjetë) pjesë të kapitalit, të barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit.

Neni 6 Transferimi i aksioneve

Aksionerët mund të transferojnë pjesërisht ose tërësisht pjesët e tyre në kapitalin e Shoqërisë sipas nenit 10 të Statutit të Shoqërisë.

Neni 7 Administrimi

Z. Arian Kraja, lindur në Tiranë, më 10/08/1965 ka të drejtën e administrimit të Shoqërisë, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe dispozitave të miratuara nga Statuti i Shoqërisë.



Neni 8
Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe ortakeve te saj, do te zgjidhet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Organi kompetent per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 9
Gjuha perdorur

Kjo Marreveshje eshte pergatitur ne gjuhen angleze, duke i bashkengjitur edhe kopjen ne shqip . Per cdo mosmarrveshje ne lidhje ne interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij akti, versioni ne gjuhen angleze do te mbizoteroje. Versioni shqip do te perdoret per qellime evidentimi.

Neni 10

Per cdo gje qe nuk eshte e shprehur qarte ne kete Statut, do te merren parasysh dispozitat e Statutit dhe ligjeve te shtetit shqiptar.

Lexuar, nenshkruar dhe miratuar

Tirane, me 28 / 06 / 2006

NENSHKRUAR

NOTERI

PERKTHYESI

Elmira Hyseni

[Signature]

DULAKU

[Signature]

FEINBERG

Benjamin Feinberg

KRAJA

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 1100 Rep.
Nr. 1162 Kol.

V Ë R T E T I M

Sot më datë 28 Qershor 2006 (dymijë e gjashtë), para meje **Ruko SAKO**, Notere Publike prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalisht :

1. **Z. Artan DULAKU**, i biri i Nikos dhe i Lirikes, lindur më 30, Maj 1965, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr. Z 0031648.
2. **Z. Benjamin FEINBERG**, i biri i Alfredit dhe i Myras, lindur më 06, Mars 1969, në Afrikën e Jugut, shtetas Izraelit, dhe banues në adresën : Bar-Ilan, Street nr. 13, Raanana, Izrael, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasportës me nr. 10914164.
3. **Z. Arian KRAJA**, i biri i Skënderit dhe i Dritës, lindur më 10, Gusht 1965, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 7/1, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z.0232605.

të cilët më deklaruan se dokumenti i bashkëngjitur këtij Vërtetimi është Akti i Themelimit të Shoqërisë "Albania Satellite Communications" SHPK, i hartuar dhe i nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe unë, noterja i vërtetoj nënshkrimin e tyre rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

Ruko SAKO



**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALBANIA SATELLITE COMMUNICATIONS"**



Bazuar ne Ligjin nr. 7638 i dates 15/11/1992 "Mbi Kompanite Tregtare", Ligjin nr. 7667 i dates 28/01/1993 "Mbi regjistrin tregtar", ne te nenshkruarit, nenvizojme si me poshte vijon:

**THEMELIMI
Neni 1**

Eshte themeluar nje Shoqeri Tregtare me emrin "ALBANIA SATELLITE COMMUNICATIONS" shpk si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe ortake si me poshte vijon:

1. Z. Artan Dulaku, biri i Nikos dhe Lirikes, lindur me 30/05/1965 ne Tirane, Shqiperi, banues ne Rr."Pjeter Bogdani" nr. 24/4, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. Z 0031648,
2. Z. Benjamin Feinberg, i biri i Alfredit dhe Myras, lindur me 06/03/69, ne Pretoria, Afrika e Jugut dhe rezident ne Bar-Ilan Street nr 13, Raanana, Israel, mbajtes i pasaportes Izraelite nr. 10914164, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.
3. Z. Arian Kraja, i biri i Skenderit dhe Drites, lindur me 10/08/1965 ne Tirane, Shqiperi, banues ne Rr. "Pjeter Bogdani", nr.7/1 Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. Z 0232605.

**SELIA
Neni 2**

Selia e shoqerise "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATION" sh.p.k eshte ne Tirane, Shqiperi, Kompleksi "Don Bosko" Kulla nr 4, Kati 2, Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Per kete arsye shoqeria mund te hapi dege te tjera ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, sipas ligjeve te vendit ku ato hapen.

**KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT
Neni 3**

Aktiviteti ekonomik i shoqerise tregtare "ALBANIA SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k eshte i pakufizuar dhe mbi 20 vjet. Kohezgjatja fillon nga data e regjistrimit ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane.



OBJEKTI I AKTIVITETIT

Neni 4

Objekti i aktivitetit të shoqërisë tregtare "ALBANIA SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k është:

- Aktiviteti i shërbimit në fushën e telekomunikacionit, transmetimit të satelitor, transmetimit të të dhënave, figure, video, kërkime, konsultime, projekte, organizim, shpërndarja e produkteve të teknologjisë së lartë, shitja dhe zbatimi i studimeve të ndryshme;
- Investime në infrastrukturën e transmetimit të të dhënave, investime direkte ose përdorimi i kapaciteteve të tregut, etj;
- Investimi i kapitalit dhe rrugë të tjera financimi për blerjen e pasurive të patundshme dhe në vazhdim të aktiviteteve të për arritjen e objektivave të shoqërisë;
- Zhvillimi i projekteve për rindertimin e ndërmarrjes industriale; sigurimin e projekteve industriale, si edhe konstituimin e kontratave afatgjate;

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, seline, objektin, kohe zgjatjen, etj, në përputhje me vendimet e marra në asamblenë e ortakëve.

KAPITALI THEMELOR

Neni 6

Kapitali themelor i shoqërisë tregtare "ALBANIA SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k është 100.000 leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale prej 1.000 leke për kuota. Ortaket kanë të drejtën e votës sipas numrit të kuotave që zotërojnë në shoqëri.

Kontributi i ortakëve në kapitalin themelor është si më poshtë:

- Z.Artan Dulaku zotëron 65% të kapitalit ose 65 kuota me vlerë 65.000 leke
- Z.Benjamin Feinberg, zotëron 25% të kapitalit ose 25 kuota me vlerë 25.000 leke
- Z.Arian Kraja zotëron 10% të kapitalit ose 10 kuota me vlerë 10.000 leke.

Neni 7

Ortakët vendosin për rritjen e kapitalit themelor sipas dispozitave të ligjeve në fuqi, të përcaktuara në mënyrë të qartë në Statutin e Shoqërisë dhe në Asamblenë e Jashtëzakonshme të Ortakëve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria është themeluar sipas dispozitave të këtij statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo quhet e krijuar ditën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkalles së parë të rrethit të Tiranës dhe pas marrjes së licencës përkatëse.

Neni 9

Ortaket nuk mund te terheqin kapitalin e derdhur. Kjo mund te ndodhe vetem pas daljes se bilancit financiar te shoqerise per fitimet e realizuara.

Neni 10

Ortaku i cili deshiron te shese pjesen e tij te quotave te kapitalit, plotesisht ose nje pjese, se pari duhet te komunikojte kete ortakeve te tjere te cilet gezojne te drejten e bleresit te pare. Ai ben nje kerkese te shkruar drejtuar Organit Administrativ duke nenvizuar cmimin e shitjes. Organi Administrativ jep pergjigjen brenda 30 diteve nga dita e lajmerimit dhe mund t'ia kaloje kete kerkese ortakeve te tjere, te cilet japin pergjigje brenda tre muajve. E drejta e perparësise duhet te komunikohet me shkrim drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e perparësise lidhet me kuotat e secilit ortak. Organi Administrativ pas 3 muajsh, brenda 30 diteve, i komunikon ortakut qe shet kuotat vendimin e ortakeve te tjere. Ne rastin kur keto kuota nuk blihen nga partneret e tjere te shoqerise, atehere ky ortak mund t'ia ofroje personave te tjere jashte shoqerise brenda 90 diteve. Tranfertat e aksioneve te kapitalit themelor duhet te jene te noterizuara dhe nje kopje duhet te jete e depozituar prane librit te ortakeve.

Kuotat e transferueshme ne rruge trashigimie do te kryhen sipas neneve 46, 47, 49 te ligjit nr. 7638 te dates 19.11.1992. Te gjitha transfertat behen te vlefshme per shoqerine ne momentin e regjistrimit ne regjistrin e ortakeve. Kuota prej 1.000 leke eshte e pandashme.

Neni 11

Emerimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emerimi i administratoreve dhe ortakeve duhet te tregohet per te gjithë personat e trete. Shoqeria ka vulen e saj me forme dhe permbajtje .

Neni 12

Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga ortaket e saj dhe organet te cilat jane:

1. Asamblea e Ortakeve
2. Administratori

Fushat e veprimit, te drejtat dhe detyrimet, marredheniet me te punesuarit dhe palet e trete, jane percaktuar nga Statuti i kesaj shoqerie.

ASAMBLEA

Neni 13

Asamblea eshte organi me i larte i shoqerise. Vendimet e marra nga Asamblea, sipas statutit dhe legjislacionit ne fuqi, jane te detyrueshme per ortaket e shoqerise.

Asamblea e shoqërisë tregtare "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k, është e përbërë nga Ortaket e saj të cilët përfaqësojnë të paktën 70% të kapitalit. Ortaket vihen në dijeni me leter rekomande ku përfshihet edhe rendi i dës, të paktën 15 dite përpara datës së mbledhjes së asamblese .

Administratori ben njoftimin.

Vendimet merren pas konsultimit të shkruar të ortakeve, neqoftese të gjithë ortaket miratojnë, me të shkruar, përmbajtjen e konsultimit.

Cdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes në vendime dhe ka një numer votash të barabartë në aksionet e kapitalit themelor që zoteron.

Në mbledhjen e Asamblese ose në konsultimet e shkruara, vendimet merren nga një ose më shumë ortakë, të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e aksioneve të kapitalit themelor.

Neqoftese kjo shumicë nuk arrihet, ortakët thirren, ose sipas cështjes, për konsultim herën e dytë dhe vendimet merren në bazë të shumicës së votave, të llogaritur sipa përqindjes së kapitalit që ato përfaqësojnë dhe neqoftese edhe këtu herë ato nuk bien dakort, atëherë konsultohet një person i tretë, një specialist për problemin në fjalë dhe vendoset në bazë të opinionit të specialistit.

Mbledhjet e Asamblese do të mbahen në gjuhën angleze, si edhe i gjithë dokumentacioni do të jetë në gjuhën angleze ose të kësaj përkthimin në anglisht.

TE DREJTAT E ASAMBLESE

Neni 14

Asamblea e ortakëve gëzon kompetencat e mëposhtme:

- Ka të drejtën e ndryshimeve, neqoftese për këtë janë dakort ortakët që së bashku përfaqësojnë $\frac{3}{4}$ e kapitalit themelor;
- Ka kompetencën e miratimit të bilancit të shoqërisë dhe të ndarjes së fitimit;
- Asamblea emëron administratoren, zv/administratoren, ekspertet dhe audituesit;
- Ka të drejtën e përjashtimit të cdo ortaku, në rastet e shkeljes së ligjit dhe të rregullave të brendshme të shoqërisë;
- Miraton cdo akt financiar që është në kompetencën e Asamblese;
- Përcaktonin shpërblyerjet për administratoren, ekspertet dhe audituesit;
- Ben transferimin e kuotave të palet e treta;
- Harton kontratat për heqjen ose dhënien e të drejtave ose të ekskluzivitetit për tregtimin dhe prodhimin e të mirave të shoqërisë dhe të kontratave të tjera që kanë të bëjnë me organe të përfaqësimit në tendera, shitje ose në cdo lloj tjetër aktiviteti të rendesishëm;
- Realizimi i blerjeve, shitjeve dhe tjetërsimit të pasurive të patundshme të shoqërisë, etj;
- Ka të drejtën e berjes së ndryshimeve në kontratën e shoqërisë;
- Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, vendimet e mëposhtme kanë nevojë për miratimin e 76% të kapitalit themelor: urdheresat ???, rritja dhe reduktimi i kapitalit, caktimi i drejtorit të përgjithshëm dhe audituesit, si edhe transaksionet relative. Shumica prej $\frac{3}{4}$ gjithashtu bie dakort të mbrojtjes së pakicës së aksionerveve të mbetur.

Neni 15

Asamblea është normale dhe e jashtëzakonshme. Asamblea mbledhet së paku 1 herë në vit, brenda 4 muajve nga data e mbylljes së aktivitetit financiar. Në rrethana të vecanta,



asamblea normale mund te mblidhet brenda 6 muajve nga data e mbylljes se aktivitetit financiar.

Asamblea e Jashtezakonshme mund te mblidhet me vendimin e saj, kur Organi Administrativ e gjykon te arsyeshme dhe kur ortaket qe perfaqesojne 10% te kapitalit e therrasin. Ne kete rast Organi administrativ ka te drejten e caktimit te dites se mbledhjes jo me vone se 30 dite nga dita e kerkeses.

Neni 16

Kur pjesmarria ne Asamble eshte normale, vendimet e marra sipas kushteve te kontrates, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi, jane te detyrueshme per te gjithë ortaket.

Cod ortak mund te perfaqesojë një ortak ose një person tjetër, i cili nuk është administrator dhe nuk mund te perfaqesojë me shume se një.

Ne Asamble mund te marrin pjese neqoftese eshte e nevojshme per dhenien e një gjykimi dhe me te drejten e votes, eksperte, auditues, etj.

Cdo vendim i marre ne menyre kolegjiale dhe asnje i tille qe secili ortak mund te marre ne menyre individuale, duhet te nenshkruhet nga te gjithë ortaket.

Neni 17

Asamblea mblidhet ne rastet e meposhtme:

- a. Ne thirrjen e pare me pranine e ortakeve ose te perfaqesuar me prokure, nga një e treta qe zoteron 10% te kapitalit themeltar.
- b. Ne thirrjen e dyte me pranine e ortakeve ose te perfaqesuar me prokure nga një e treta qe zoteron 75% te kapitalit themeltar.

Neqoftese ne thirrjen e pare asamblea nuk mblidhet, ne thirrjen e dyte ai mund te vendose vetem per problemet e rendit te dites, gjithmone me pranine e ortakeve, ku njera nga firmat duhet te jete e Drejtuesit te Asamblese. Ne te dyja rastet, e asamblese normale dhe e jashtezakonshme, kur drejtuesi ose perfaqesuesi i tij mungojne, asamblea shtyhet per një date tjetër. Neqoftese njeri nga ortaket mund ta perfaqesojë ate me prokure, asamblea mund te procedoje normalisht.

ADMINISTRIMI

Neni 18

Administratori i emeruar ka te gjitha kompetencat ne marredheniet e me palet e treta, pervec kompetences qe ligji i jep shprehimisht Asamblese se shoqerise dhe pervec pageses se shpenzimeve. Ne kete rast shoqeria nuk eshte pergjegjese per konsequencat qe mund te kene palet e treta dhe administratori eshte i pergjegjshem ne rruge individuale. Administratori i Emeruar mund te hiqet me vendim te ortakeve, kur ata perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit themelor.

Shoqeria tregtare "ALBANIA SATELLITE COMMUNICATIONS" sh.p.k administrohet nga Administratori i tij :



- Z. Arian Kraja, lindur ne Tirane, Shqiperi, banues ne Rr."Pjeter Bogdani", P.7/1, Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. Z 0232605.

Neni 19

Administratori ka te gjithë fuqine e nevojshme per te vepruar ne emer te shoqerise, ne lidhje me palet e treta, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te te drejtave qe ligji shprehimisht i jep ortakeve, te kryeje cdo lloj transaksioni bankar deri ne 100.000 USD, por keto transaksione do te behen vetem per administrimin normal te biznesit.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe dalin nga veprimet e administratorit, edhe kur keto veprime nuk jane te perfshire ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte pergjegjese per pasojat kundrejt paleve te treta, kur provohet qe palet e treta kishin dijeni se veprimi i administratorit tejkalonte objektin e aktivitetit te shoqerise ose kur palet e treta nuk mund te jene te pavetedijshme per kete veprim sipas rrethanavete caktuara, duke patur parasysh faktin se shpallja vetem e statutit nuk eshte nje prove e mjaftueshme.

Administratoret jane individualisht ose kolektivisht pergjegjes, sipas rastit, kundrejt shoqerise ose paleve te treta, te ligjit ose shkelje te statutit, ose shkelje te tjera te bera gjate administritimit te shoqerise.

Asnje vendim i Asamblese nuk mund te ndaloje padine e kerkuar kundrejt administratoreve qe ka te beje me gabimet e tyre gjate ushtrimit te detyres.

Ortakët kane keto te drejta themelore:

- te administrojne aktivitetin e shoqerise ne perputhje me Statutin dhe aktin themelues;
- te ndajne fitimet ne cdo lloj forme dhe sasie, qe vijne nga aktiviteti i shoqerise, sipas statutit dhe aktit te themelimit;
- te kene ne cdo moment dokumenta te tilla si: raportet e administrimit, inventarin dhe llogarite vjetore per tre vitet e fundit;
- te terhiqen nga shoqeria, duke ofruar aksionet e tyre me prioritet per ortakët e tjere. Ne rastin e mosushtrimit te se drejtes se perparesise nga ortakët, kuotat mund te transferohen te te tretet.

MARRREDHENIET E PUNES

Neni 20

Ceshtjet e punes, pagat, principet qe ndiqen per percaktimin e oreve te punes dhe diteve te pushimit, materialeve nxitese dhe sigurimet profesionale dhe shendetesore do te rregullohen nga kontrata e punes. Per ceshtjet qe nuk jane te perfshira ne kontraten e punes do te zbatohet Legjislacioni shqiptar i Punes.

KONTROLLI I BRENDSEHEM

Neni 21

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me eksperte kontabel te autorizuar, me mundesine e emerimit dhe shkarkimit. Ekspertet kontabel kontrollojne dhe garantojne pligjin shqiptar ne fuqi. Ato jane pergjegjes kundrejt kompanise dhe paleve te treta per demtimet e shkaktuara si pasoje e nenvleresimit te fakteve dhe detyrave.



BILANCI DHE AKTIVET

Neni 22

Viti financiar i shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo viti financiar Administratori i shoqërisë përgatit Raportin Financiar Vjetor dhe Bilancin Kontabel, me Fitimin dhe Humbjet e shoqërisë, dokumentet e llogarive sipas ligjeve shqiptare në fuqi për kontabilitetin.

Asambleja e shoqërisë aprovon Bilancin Vjetor brenda tre-muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

Pas miratimit të Bilancit Vjetor shoqëria vendos krijimin e fondeve të ndryshme si fondet akumulative dhe fondet rezerve, etj.

MBARIMI I SHOQËRISË

Neni 23

Veprimtaria e shoqërisë mund të pushojë në çdo moment për arsye të ndryshme si: falimentimi, kurrë aktiviteti i shoqërisë nuk i korrespondon qëllimeve dhe objektivave të Kontrates dhe të këtij Statuti, forca mëdha dhe çdo faktor tjetër i cili nuk varet nga dëshira e Asamblesë së Shoqërisë.

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve do të caktojë një Komision Likuidimi dhe do të emerojë një ose disa likuidatorë .

Në këtë rast shoqëria quhet "Shoqëri në likuidim".

Likuiduesit dhe administratorët janë përgjegjës për likuidimin e aktivitetit të shoqërisë. Ata kanë të drejtën e administrimit të pronave të shoqërisë, të kujdesen për procesin e likuidimit, së pari kundrejt paleve të treta, pastaj midis ortakëve, gjithmone në proporcion me aksionet që ato zoterojnë në kapitalin themelor.

Në fund të procesit të likuidimit asambleja merr vendim në lidhje me bilancin financiar, punë kryer nga likuidatori/et dhe përfundimin e procesit të likuidimit.

Pas procesit të likuidimit shoqëria nga Rregjistri Tregtar i Gjykatës së Tiranës.

LIBRI I SHOQËRISË

Neni 24

Shoqëria duhet të bazuar në legjislacionin në fuqi mbi këto libra:

1. Libri i ortakëve
2. Libri i mbledhjeve
3. Libri i vendimeve të Administratorit
4. Libri i Mbledhjeve, Eksperteve dhe Revizoreve.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 25

Per cdo gje qe nuk eshte e shprehur qarte ne kete Statut, do te merren parasysh plotesimet e bera nga Asamblea e Shoqerise dhe nga legjislacioni shqiptar.


Te gjitha ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti do te behen ne perputhje me te njejtat ligje te Kontrates dhe te ketij Statuti, vecanarisht duke u bazuar ne ligjin nr.7638 i dates 19/11/1992 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet e tjera qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

Neni 26


Ky statut eshte hartuar ne 6 (gjashte) kopje ne gjuhen shqipe, duke i bashkengjitur edhe kopjen ne anglisht. Per cdo mosmarrveshje ne lidhje ne interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij akti, versioni anglisht do te jete i vetmi me fuqi ligjore.

ORTAKET


1. Artan Dulaku



2. Benjamin Feinberg



3. Z. Arian Kraja



Në prezencë të përfaqësues
Elmira Hysoni 

RUKO SAKO
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE

